

**Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit
Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.
Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit
Financiar për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare.....	4
1. Informacione të përgjithshme.....	5
2. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme	5
3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara	11
4. Standardet dhe interpretimet e reja.....	12
5. Menaxhimi i rrezikut financiar	13
6. Vlerësime kritike kontabël dhe gjykime	18
7. Paraqitja me vlerën e drejtë	18
8. Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to	20
9. Depozita me afat me bankat	20
10. Investime në letra me vlerë.....	20
11. Aktive të tjera	20
12. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	21
13. Detyrime të tjera	21
14. Kapitali aksionar	21
15. Të ardhura nga tarifa e administrimit.....	22
16. Të ardhura nga nterest	22
17. Shpenzime personeli	22
18. Shpenzime Administrative	23
19. Tatim fitimi.....	23
20. Angazhime dhe detyrime të konstatuara	24
21. Transaksionet me palët e lidhura	24
22. Ngjarje pas dates së raportimit	24



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve dhe Bordit Mbikëqyrës të Sh.A.F.P Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve ("Sh.A.F.P") Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, SkyTower, kati 9, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Raporti i Audituesit të Pavarur (vazhdim)

Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
31 maj 2017
Tiranë, Shqipëri

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor




Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)


Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	8	22,049	1,191,228
Depozita me afat	9	6,650,912	2,629,381
Investime në letra me vlerë	10	15,217,124	15,217,124
Tatim fitim i parapaguar		-	390,000
Aktive të tjera	11	1,856,561	107,064
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	12	2,309,546	2,581,885
TOTALI AKTIVEVE		26,056,192	22,116,682
DETYRIMET			
Detyrime të tjera	13	1,522,143	1,420,606
Tatim fitimi		390,029	-
Totali i detyrimeve		1,912,172	1,420,606
Kapitali			
Kapitali i paguar	14	57,028,800	57,028,800
Humbje të mbartura		(32,884,780)	(36,332,724)
Totali i Kapitalit		24,144,020	20,696,076
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		26,056,192	22,116,682

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a. më 15 Maj 2017 dhe janë firmosur nga:


 Naim Hasa
 Drejtor i Përgjithshëm




 Junida Zavalani
 Specialiste finance

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

	Shënime	2016	2015
Të ardhura nga tarifa e administrimit	15	17,724,620	11,954,758
Të ardhura nga interesi	16	1,055,530	703,769
		18,780,150	12,658,527
Shpenzime për personelin	17	(10,932,111)	(8,965,598)
Amortizimi	12	(272,339)	(307,839)
Shpenzime administrative	18	(3,347,727)	(2,241,301)
Totali i shpenzimeve		(14,552,177)	(11,514,738)
Fitim para tatimit		4,227,973	1,143,789
Tatim mbi fitimin	19	(780,029)	-
Fitim për vitin		3,447,944	1,143,789
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		3,447,944	1,143,789

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i paguar	Humbje e mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	57,028,800	(37,476,513)	19,552,287
Fitimi i vitit	-	1,143,789	1,143,789
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën</i>	-	1,143,789	1,143,789
Gjendja më 31 dhjetor 2015	57,028,800	(36,332,724)	20,696,076
Gjendja më 31 janar 2016	57,028,800	(36,332,724)	20,696,076
Fitimi i vitit	-	3,447,944	3,447,944
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën</i>	-	3,447,944	3,447,944
Gjendja më 31 dhjetor 2016	57,028,800	(32,884,780)	24,144,020

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

Pasqyra e flukseve monetare

	Shënime	2016	2015
Flukset monetare nga aktivitete operative			
Fitimi para tatimit		4,227,973	1,143,789
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	12	272,339	307,839
Të ardhura nga investimi në letra me vlerë		(1,055,530)	(703,769)
Flukset monetare nga aktivitete operative përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet qarkulluese		3,444,782	747,859
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet qarkulluese:</i>			
Ndryshim në aktive të tjera		(1,749,497)	5021
Ndryshim në detyrime të tjera		101,537	(303,233)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet operative		(1,647,960)	(298,212)
Interesi i arkëtuar		1,033,999	520,552
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet operative		2,830,821	970,199
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Ndryshime në depozita me afat		(4,000,000)	4,900,000
Ndryshime në investime		-	(15,000,000)
Flukse monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese		(4,000,000)	(10,100,000)
Rënia neto në flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre		(1,169,179)	(9,129,801)
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës		1,191,228	10,321,029
Flukset monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	8	22,049	1,191,228

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në faqen 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione të përgjithshme

Këto janë pasqyrat financiare të Shoqëria administruese e fondit të pensioneve (Sh.A.F.P) Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a ("Shoqëria"), për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2016 përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNFR").

Shoqëria është një shoqëri aksionere shqiptare me seli në Shqipëri. Shoqëria është e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me Vendim të Gjykatës së Rrethit, Tiranë Nr. 34877, më datë 21 janar 2006.

Aktiviteti kryesor

Më 30 Mars 2011, Autoriteti shqiptar i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") licencoi "Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria sh.a" për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar, në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit. Ky miratim iu njoftua dhe dorëzua Shoqërisë zyrtarisht nga AMF më 30 Mars 2011.

Adresa e regjistruar

Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në rrugën "Bulevardi Zogi I", Nr.1, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria zotërohet 51% nga SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA dhe 49% nga z. Avni Ponari.

Shoqëria mëmë dhe pala kontrolluese është Sigal Uniqa Group Austria Sh.a.

Operacionet drejtohen nga bordi mbikqyrës që përbëhet nga pesë anëtarë: Z.Adrian Totokoçi, Z.Klement Mersini, Z.Naim Hasa, Z.Abdyl Sarja, Z.Edvin Hoxhaj

Administratori i shoqërisë që emërohet nga bordi mbikqyrës është Z. Naim Hasa.

2. Përmbledhje e politikave kontabël të rëndësishme

a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") nën parimin e kostos historike. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë përcaktuar më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë konsistente në të gjithë periodat, përveç se në rastet kur specifikohet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të përcaktuara. Gjithashtu kërkohet që Bordi i Drejtorëve të zhvillojë vlerësimet e tij përgjatë zbatimit të politikave kontabël. Fushat në të cilat kërkohet një vëmendje më e madhe ose që janë komplekse, ose ku gjykimet dhe vlerësimet janë thelbësore për pasqyrat financiare janë paraqitur në shënimin 6.

b) Përkthimi në monedhë të huaj

Monedha funksionale dhe e prezantimit Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Monedha funksionale e Shoqërisë është monedha në mjedisin primar ekonomik në të cilin ajo operon.

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

b) Përkthimi në monedhë të huaj (vazhdim)

Transaksionet dhe balancat Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Aktivet dhe pasivet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e përgatitjes së pasqyrës së pozicionit financiar.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i kursit të këmbimit valutor janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Fitimet dhe humbjet që lidhen me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre nga këmbimi valutor janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse brenda zërit 'fitimet neto në monedhë të huaj apo humbjet në mjete monetare dhe ekuivalente të tyre'.

Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që lidhen me aktivet dhe detyrimet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse brenda zërit "ndryshime të tjera neto në vlerën e drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes".

c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Shoqërisë maten me koston e amortizuar në varësi të kategorisë së tyre të matjes.

i) Njohja

Instrumentet financiare të shoqërisë (aktivet dhe detyrimet) njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus koston e transaksionit. Vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare evidentohet më mirë nëpërmjet çmimit të transaksionit. Një fitim ose humbje në momentin fillestar do të njihet vetëm nëse ka ndonjë diferencë ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të vëzhgueshme në treg për të njëjtin instrument ose nëpërmjet një teknike vlerësimi inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshëm.

ii) Klasifikimi

Aktivt financiarë ndahen në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe të arkëtueshme (depozita me afat në banka dhe sigurime të arkëtueshme) dhe (b) aktive financiare të mbajtura deri në maturim (MDM). Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (duke përfshirë detyrime të sigurimit/tregtare dhe detyrime të tjera) dhe shpërndahen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe njihen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua dhe të arkëtueshme janë aktive financiare jo derivative dhe me pagesa fikse ose të përcaktueshme, përveç atyre që shoqëria ka synim të shesë në një afat të afërt. Hua-të dhe të arkëtueshmet përfshijnë depozitat me afat me bankat dhe sigurime dhe të tjera të arkëtueshme dhe njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionet për humbjet e ndodhura nga zhvlerësimi.

Aktivt financiarë të mbajtura deri në maturim përfshijnë aktive financiare të pakuotuar, jo derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe maturitete fikse, për të cilat shoqëria ka synimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Menaxhimi përcakton klasifikimin e letrave me vlerë të sigurimit të mbajtura deri në maturim gjatë njohjes fillestare dhe rivlerëson përshtatshmërinë e këtij klasifikimi në fund të çdo periudhe raportimi. Investimet të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke i zbritur provizionet për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

c) Instrumentet financiare (vazhdim)

iii) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur : (a) aktivet janë kthyer ose mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur (b) shoqëria ka transferuar të drejtat për të arkëtuar flukse monetare nga aktivi financiar ose ka hyrë në një marrëveshje përçimi ndërkohë (i) gjithashtu transferon në mënyrë të rëndësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet të pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon as mban në mënyrë të rëndësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por as duke mbajtur kontroll.

Kontrolli mbahet kur pala tjetër nuk ka aftësitë praktike për të shitur aktivin në tërësi ndaj një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojën të vendosë kufizime të mëtejshme për shitjen.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

iv) Matja e kostos së amortizuar

Kosto e amortizuar është vlera me të cilën aktivi financiar është njohur në momentin fillestar duke zbritur çdo ripagesë principali, plus interesin e përlogaritur dhe për aktivet financiare duke zbritur çdo zhvlerësim për humbje të ndodhura. Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në momentin e njohjes fillestare dhe të çdo primi apo skontimi të vlerës deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e përlogaritura dhe shpenzimet e përlogaritura të interesit, duke përfshirë dhe kuponin e përlogaritur dhe skontimin ose primin e amortizuar (duke përfshirë tarifat e shtyra që në krijim, nëse ka), nuk paraqiten të ndara dhe janë të përfshira në vlerën kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar.

v) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka një të drejtë të detyrueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim ose për të shlyer mbi një bazë neto, ose për të realizuar aktivin dhe shlyer detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme, si ato në aktivitetin tregtues të Fondit.

vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbartura me koston e amortizuar

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje kur kanë ndodhur si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve ("ngjarje me humbje") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar të cilat kanë ndikim në shumën apo kohën e flukseve të ardhshme të çmuara të aktivitetit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Nëse Shoqëria përcakton se nuk ka evidencë objektive që ekziston zhvlerësimi për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup të aktiveve financiare me karakteristikë të ngjashme të rrezikut të kredisë, dhe vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre. Faktorët kryesorë që Shoqëria konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i kalimit të afatit, detyrimet që mund të netohen për të njëjtin klient dhe realizueshmërinë e kolateralit përkatës, nëse ka. Kriteret e mëposhtme janë përdorur gjithashtu për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi ka ndodhur kur :

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

c) Instrumentet financiare (vazhdim)

- ndonjë pjesë ose kësti i ka kaluar afati dhe pagesa të vonuara nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes;
- pala tjetër ka një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informatat e saj financiare që Shoqëria merr;
- pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim financiar;
- ka ndryshim negativ në statusin e pagesave të palës tjetër si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë palën tjetër; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, në mënyrë të konsiderueshme zvogëlohet si rezultat i përkeqësimit të kushteve të tregut.

d) Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investimet e tjera afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Depozitat me afat maturimi më shumë se tre muaj klasifikohen si depozita me afat me bankat, si një nën-kategori të kredive dhe të aktiveve financiare të arkëtueshme.

e) Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen si ato të cilat kanë një afat maturimi më të madh se 3 muaj. Interesi llogaritet në bazë rrjedhëse duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në llogaritë e tjera të arkëtueshme.

f) Investime në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë tituj borxhi të cilët Shoqëria ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe klasifikohen si aktive për tu mbajtur deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat janë me qëllim për t'u mbajtur në maturim maten me kosto të amortizuar, minus parashikimin për zhvlerësim në vlerë. Kosto e amortizuar është përlllogaritur duke marrë në llogari ndonjë zbritje apo prim në blerje.

g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto

i. Njohja dhe matja

Zërat e ndërtesës dhe paisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë si edhe kostot çmontimit e rikthimit të vendit në të cilin ato do të vendosen, në gjendjen e tij fillestare. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të paisjes kapitalizohet si pjesë e paisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose paisjeve kanë jetgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe paisjeve.

ii. Kostot e mëpasme

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të ndërtesës dhe paisjeve, i shtohet vlerës së mbartur të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me këtë element do të shkojnë për Shoqërinë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore të ndërtesave dhe paisjeve njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Aktivët e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe ate krahasuese është si më poshtë:

Kategoria	2016	2015
Makina	10	10
Pajisje zyre	10	10
Komputera dhe instalime	25	25

h) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Në çdo fund të çdo periudhe raportimi manaxhimi vlerëson nëse ka evidenca për zhvlerësim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ka tregues të tillë, manaxhimi vlerëson shumën e rikuperueshme, që përcaktohet sim ë e larta midis vlerës së drejtë të aktivit minus kostot dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël reduktohet deri në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njihur për një aktiv në vitet e mëparshme inversohet atz ku është e përshtatshme nëse ka patur një ndryshim në vlerësimet e përdorura që përcaktojnë vlerën në përdorim të aktivit ose vlerës së drejtë minus kosto për të shitur.

i) Tatimi Fitimi

Tatimi mbi të ardhurat janë paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që deri në fund të periudhës së raportimit. Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse është njohur në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose direct në capital sepse lidhet me transaksione që janë gjithashtu të njohura, në të njëjtën ose periudha të ndryshme, në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose direct në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhen ndaj, ose rimerret nga, autoritet tatimore në lidhje me fitimet e tatueshme ose humbjet për periudhën aktuale dhe të mëparshme. Fitimi i tatueshëm ose humbjet janë bazuar në vlerësime nëse pasqyrat financiare janë autorizuar para parashtrimit të deklarimit tatimor. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat janë rregjistruar në shpenzime operative.

Tatimi mbi të ardhurat i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit për humbje tatimi të bartura dhe diferencat e përkohshme që rrjedhin midis bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së mbartur për qëllime të raportimit finnciar. Në përputhje me përjashtimin e njohjes fillestare, tatimet e shtyra nuk janë rregjistruar për diferenca të përkohëshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion përveç se një kombinimi biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet as në fitim të tatueshëm. Balancet e shtyra tatimore maten me normat e taksave në fuqi ose në fuqi në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të aplikohen në momentin që diferencat e përkohshme do të inversohen ose humbjet e shtyra tatimore do të përdoren (2016: 15%, 2015:15%). Aktivët tatimore të shtyra për diferencat e zbritshme të përkohshme dhe humbjet e mbartura tatimore janë rregjistruar vetë në shtrirjen që është e mundshme që fitimet tatimore të ardhshme do të jenë në dispozicion ndaj zbritjeve që mund të përdoren.

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

i) Tatimi Fitimi (vazhdim)

Pozicione tatimore të pasigurta Pozicionet tatimore të pasigurta të Grupit janë rivlerësuar nga manaxhimi në fund të çdo periudhe të raportimit. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat që janë të përcaktuara nga manaxhimi si me më shumë gjasa se nuk do të rezultojnë në taksat shtesë të vendosura në qoftë se pozicionet do të sfidoheheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi është bazuar në interpretimin e ligjeve tatimore që janë në fuqi ose që ishin në fuqi deri në fund të periudhës së raportimit, dhe çdo gjykatë të njohur apo vendimeve të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjoba, interesa dhe taksa të tjera përveç atyre mbi të ardhurat njihen në bazë të vlerësimit më të mirë të drejtimit të shpenzimit të kërkuar për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

Tatimi mbi vlerën e shtuar Tatimi mbi vlerën e prodhimit të shtuar në lidhje me shitjet është e pagueshme për organet tatimore më herët se (a) mbledhja e të arkëtueshmeve nga klientët ose (b) shpërndarja e mallrave ose shërbimeve për klientët. TVSH e zbritshme është përgjithësisht e rikuperueshme kundër TVSh së mbledhshme pas marrjes së faturës së TVSH. Organet tatimore lejojnë zgjidhjen e TVSH-së në baza neto. TVSH në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar mbi bazë bruto dhe të shpalosen veçmas si një aktiv dhe pasiv. Aty ku është bërë provigjion për zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme, humbja nga zhvlerësimi është i regjistruar në shumën bruto të debitorit, duke përfshirë edhe TVSH-në.

j) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kosto shtesë drejtpërdrejt të atribueshme për lëshimin e aksioneve të reja janë paraqitur në kapitalin neto si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të shumës së arkëtuar mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si premium i aksioneve në kapitalin neto.

Dividendë

Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë të deklaruar dhe të miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas datës së bilancit dhe para se pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim janë shpalosur në shënimin e ngjarjeve pas datës së bilancit.

k) Të ardhurat nga investimi

Të ardhurat dhe shpenzimet për investime njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat vlerësuar monetare të ardhshme dhe arkëtimet përmes jetës së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) për vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar. Të ardhurat nga investimet paraqiten në fitim ose humbje dhe përfshijnë interesin për aktivet financiare të kompanisë.

l) Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria bën kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve pas daljes në pension. Autoritetet përkatëse të sigurimeve shoqërore janë përgjegjës për përcaktimin e minimumit ligjor të vendosur pension sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributi i kompanisë për planin e pensionit është i ngarkuar në fitim dhe humbje kur kanë ndodhur.

2. Përmbledhja e politikave kontabël të rëndësishme (vazhdim)

l) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

(ii) Pushimet vjetore të pagueshme

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën e përfunduar.

m) Të ardhurat nga komisioni

Të ardhurat përbëhen nga vlera e drejtë e shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar për shërbimet në rrjedhën e zakonshme të veprimtarisë së shoqërisë. Të ardhurat neto tregohen neto ndaj tatimit mbi vlerën e shtuar.

Kompania njih të ardhurat, kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin tek njësia ekonomike dhe kriteret specifike janë plotësuar për secilin nga aktivitetet e shoqërisë siç përshkruhet më poshtë.

Taksa e menaxhimit kalkulohet në baza ditore, si 3% të aktiveve neto vlera e fondit të pensioneve. Tarifa e hershme përfundimin, paguhet nga ata që kontribuan për tërheqjen e hershme nga pensioni, është llogaritur si 15% e vlerës së fondit të kontribuesit neto (duke përjashtuar tatimit në burim) në ditën e tërheqjes.

3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janar 2016:

- SNRF 14, Llogaritë e shtyra (publikuar në janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Kontabiliteti për blerjen e interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Qartësimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018) .
- Bujqësi: Bimët prodhuese - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Ndryshimet e SNK 1 në sajë të projektit për shënimet shpjeguese (publikuar në dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janar 2016) .
- Njësia ekonomike investuese: Aplikimi i ndryshimit mbi përjashtimin e konsolidimit në lidhje me SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në dhjetor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore për ose pas 1 janar 2016).

3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).

Standartet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Standardet dhe interpretimet e reja

Standarde të caktuara të reja dhe interpretime janë lëshuar që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë me 1 janar 2017 ose më vonë, dhe që shoqëria nuk ka miratuar më herët.

SNRF 9, “Instrumentet financiare” (publikuar në korrik 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura më pas me kosto të amortizueshme, aktive të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe ato të matura më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.
- Klasifikimi i instrumenteve të huasë bazohet tek modeli i biznesit të njësisë në menaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktit nëse flukset monetare kontraktuale rrjedhin kryesisht nga pagesat e interesit dhe të kryegjësë. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të kryegjësë dhe interesave. Instrumentet e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Aktivet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo kryegjë duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të kryegjësë dhe interesave.
- Investimet në instrumente të kapitalit maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Sidoqoftë, drejtimi i shoqërisë mund zgjedhë të paraqesë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që instrumenti të mos mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në pasqyrën e fitim humbjes.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit – modelin e humbjeve të pritura kreditorë. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë kreditorë të aktivitetit financiar që nga njohja.
- Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitë duhet të njohin një humbje të drejtpërdrejtë të barabartë me humbjet e pritura kreditorë për 12 muaj në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi kreditor (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura kreditorë për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në rrezikun kreditor, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 mujor. Ky model përfshin lehtësira operationale për qiranë dhe llogaritë e arkëtueshme.
- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë rishikuar për një përshtatje më të mirë ndërmjet kontabilitetit dhe menaxhimit të rrezikut. Standardi i jep njësive mundësi zgjedhje midis zbatimit të kërkesave të kontabilitetit të mbrojtës të SNRF 9 dhe zbatimit të SNK 39 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin mbrojtës në nivel makro.

4. Standardet dhe interpretimet e reja (vazhdim)

Shoqëria nuk pritet të ketë një ndikim material nga standardi i ri në lidhje me klasifikimin dhe matjen. Kontabiliteti mbrotjës nuk ndikon në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë, pasi shoqëria nuk kryen transaksione të tilla.

Standardet e reja ose të ndryshuara nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të shoqërisë.

- SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Projektit për shënimet shpjeguese – Ndryshime në SNK 7 (publikuar në 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2017).
- Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe pjesëmarrjes së tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date për t'u përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit).
- Njohja e aktivitetit të tatimit të shtyrë për humbje të përealizuara – Ndryshime në SNK 12 (publikuar në 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017).
- Ndryshime në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar në 12 prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Ndryshime në SNRF 2, Pagesa të bazuara në aksione (publikuar në 20 qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).
- Ndryshime në SNRF 4, Kontratat e sigurimit (publikuar në 12 Shtator 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndajë një shumëllojshmëri të rreziqeve financiare: rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, vlerën e drejtë të rrezikut të normës së interesit, rrezikun e normës së interesit të flukseve monetare dhe rrezikun të çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun të likuiditetit.

Në përputhje me Ligjin nr.10197 i datës 10 dhjetor 2009 "Mbi fondet vullnetar të pensionit ", Shoqëria e manaxhimit ka ngritur një funksion të veçantë të dedikuar për administrimin e rrezikut.

Roli i manaxhimit të rrezikut në strukturën e shoqërisë përfshin përgjegjësi në lidhje me manaxhimin e rreziqeve që raportojnë drejtpërdrejt në Bordin Mbikëqyrës.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Politika e menaxhimit të rrezikut është zhvilluar duke u bazuar në strukturën themelore të fondit të pensionit manaxhuar nga shoqëria dhe tolerancën e rrezikut të vënë përpara në politikat e investimeve dhe të kërkesat të legjislacionit të Fondit.

Administrimi i rrezikut financiar fillon nga identifikimin e rreziqeve, përcaktimi i burimeve të duhura për menaxhimin e rrezikut, vendosja e afateve për ekspozimet, monitorimi i limiteve, dhe përshtatjen e ekspozimeve ndaj intervaleve të kërkuara.

Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Aktiviteti i Fondit monitorohet dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA. Sh.a ("Shoqëria Administruese") në bazë të ligjit nr. 10197, datë 10 Dhjetor 2009 mbi "Fondet Vullnetare të Pensionit", Shoqëria Administruese duhet të ketë një funksion të veçantë dedikuar menaxhimit të rrezikut.

Kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi implementimin e politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administrative ; aprovimin e politikave financiare dhe investuese; caktimin dhe shkarkimin e administratorëve ose anëtarëve të Komitetit të Investimit. Këshilli Administrativ është i përkushtuar në sigurimin që veprimet e Shoqërisë Administruese janë në përputhje me standardet ligjore dhe të kontabilitetit.

Këshilli Administrativ caktoi anëtarët e Komitetit Investues si më poshtë:

- Z. Naim Hasa, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese.
- Z. Klement Mersini, Drejori Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Z. Ilir Hoti, Konsulent Financiar i "Sigal Uniqa Group Austria Sh.a"
- Znj. Esmeralda Shehaj, Pedagoqe e Universitetit të Tiranës, Fakulteti Ekonomik and Konsulente mbi investimet dhe menaxhimin e rrezikut.

Komiteti i Investimit organizon jo më pak se katër mbledhje në vit, në mënyrë që të zhvillojë politika investimi, të kryejë alokimin dhe modifikimin e aktiveve dhe t'ia paraqesë ato Shoqërisë Administruese. Këto politika mbështeten mbi analiza sasiore dhe cilësore të tregjeve të kapitalit, tregjeve të riskut dhe analiza të tjera teknike në përputhje me kufizimet dhe kufijtë maksimum të investimit të përcaktuar nga ligji dhe rregulloret e përmendura më lart.

5.1 Rreziku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në: (a) valutë të huaj, (b) aktive dhe detyrime interesmbajtëse dhe (c) produkte të kapitalit, ku të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhimi vendos limite mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, që monitorohet mbi një bazë ditore. Megjithatë përdorimi i kësaj përjasjeje nuk i parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëritë ndaj rreziqeve të tregut të përfshira më poshtë bazohen në ndryshimin e një faktori duke mbajtur faktorët e tjerë të pandryshuar. Në praktikë kjo ka shumë pak mundësi të ndodhë dhe ndryshimet në disa prej faktorëve mund të jenë të korreluar për shembull me ndryshimet në normat e interesit dhe ndryshimet në kurset e këmbimit.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.1 Risku i tregut (vazhdim)

a) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit. Rreziku i kursit të këmbimit lind sepse vlera e transaksioneve të ardhshme, aktiveve monetare të njohura dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedha të tjera luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Manaxhimi monitoron ekspozimin e të gjithë aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedhë të huaj.

Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lek për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
USD	128.17	125.79
Euro	135.23	137.28

Ekspozimet në monedhë të huaj përmbajnë riskun e lëvizjeve jo të favorshme në kursin e këmbimit. Aktivët dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 përbehen si më poshtë:

31 dhjetor 2016

Aktive	LEK	EUR	Total
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	22,049	-	22,049
Depozita me afat	6,650,912	-	6,650,912
Investim në letra me vlerë	15,217,124	-	15,217,124
Aktive të tjera financiare	1,687,891	-	1,687,891
Totali aktive financiare	23,577,976	-	23,577,976
Detyrime			
Detyrime të tjera	1,040,825	-	1,040,825
Totali detyrime financiare	1,040,825	-	1,040,825
Pozicioni Neto	22,537,151	-	22,537,151

31 dhjetor 2015

Aktive	LEK	EUR	Total
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,191,228	-	1,191,228
Depozita me afat	2,629,381	-	2,629,381
Investim në letra me vlerë	15,217,124	-	15,217,124
Totali aktive financiare	19,037,733	-	19,037,733
Detyrime			
Detyrime të tjera	1,069,662	-	1,069,662
Totali detyrime financiare	1,069,662	-	1,069,662
Pozicioni Neto	17,968,071	-	17,968,071

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

b) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga efektet e rrezikut të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e rrjedhjes së parasë financiare. Gjatësinë e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar, pra tregon se deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesit janë të lidhura në mënyrë të zhdrejtë. Nga ana tjetër, një mjedis i ulët i normës së interesit e bën të vështirë për shoqërinë për të ofruar një normë adekuate të brendshme të kthimit.

31 dhjetor 2016	Vlera e mbartur	Më pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit
Aktive financiare				
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	22,049	22,049	-	-
Depozita me afat	6,650,912	-	2,620,056	4,030,856
Investim në letra me vlerë	15,217,124	-	-	15,217,124
Aktive të tjera financiare	1,687,891	1,687,891	-	-
Totali aktive financiare	23,577,976	1,709,940	2,620,056	19,247,980
Detyrime financiare				
Detyrime të tjera	1,040,825	1,040,825	-	-
Totali detyrimeve financiare	1,040,825	1,040,825	-	-
Hendeku i norms së interesit	22,537,151	669,115	2,620,056	19,247,980

31 dhjetor 2015	Vlera e mbartur	Më pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 deri 5 vite
Aktive financiare					
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,191,228	1,191,228	-	-	-
Depozita me afat	2,629,381	-	-	2,629,381	-
Investim në letra me vlerë	15,217,124	-	-	-	15,217,124
Totali aktive financiare	19,037,733	1,191,228	-	2,629,381	15,217,124
Detyrime financiare					
Detyrime të tjera	1,069,662	1,069,662	-	-	-
Totali detyrimeve financiare	1,069,662	1,069,662	-	-	-
Hendeku i norms së interesit	17,968,071	121,566	-	2,629,381	15,217,124

Një zhvendosje paralele në kurbën e yield-it nga 100bp për portofolin e letrave me vlerë me të ardhura të Shoqërisë ka një ndikim neto me Fitim/Humbje prej 218,680 Lekë (2015: 178,843 Lekë)

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.1 Rreziku i tregut (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria nuk mund të jetë në gjendje të gjenerojnë burime të mjaftueshme të të ardhurave për të zgjidhur detyrimet e saj në mënyrë të plotë në momentin që ato matorohen. Politika e shoqërisë është për të investuar shumicën e aseteve të saj në investime që janë të tregtueshme në një treg aktiv dhe mund të hidhen lehtësisht.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 Dhjetor deri në 2016 dhe 2015 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2016	Vlera e mbartur	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite
Aktive financiare						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	22,049	22,049	22,049	-	-	-
Depozita me afat	6,650,912	6,650,912	-	-	6,650,912	-
Investime në letra me vlerë	15,217,124	19,591,500	-	-	1,034,000	-
Aktive të tjera financiare	1,687,891	1,687,891	1,687,891	-	-	-
Totali aktive financiare	23,577,976	27,952,352	1,709,940	3,654,056	22,588,356	-
Detyrime financiare						
Detyrime të tjera	1,040,825	1,040,825	1,040,825	-	-	-
Totali detyrimeve financiare	1,040,825	1,040,825	1,040,825	-	-	-
Hendeku neto i maturimit	22,537,151	26,911,527	669,115	3,654,056	22,588,356	-
Efekti i akumuluar	-	-	669,115	4,323,171	26,911,527	-

31 dhjetor 2015	Vlera e mbartur	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1-5 vite
Aktive financiare						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1,191,228	1,191,228	1,191,228	-	-	-
Depozita me afat	2,629,381	2,629,381	-	-	2,629,381	-
Investime në letra me vlerë	15,217,124	20,625,500	-	-	1,034,000	19,591,500
Totali aktive financiare	19,037,733	24,446,109	1,191,228	-	3,663,381	19,591,500
Detyrime financiare						
Detyrime të tjera	1,069,662	1,069,662	1,069,662	-	-	-
Totali detyrimeve financiare	1,069,662	1,069,662	1,069,662	-	-	-
Hendeku neto i maturimit	17,968,071	23,376,447	121,566	-	3,663,381	19,591,500
Efekti i akumuluar	-	-	121,566	121,566	3,784,947	23,376,447

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

5.2 Rreziku i kredisë

Emetuesit e instrumenteve të borxhit të përfshira në portofol mund të mos paguajnë interesa dhe pagesa të principalit. Përkeqësimi në cilësinë e kredisë gjithashtu nënkupton rënie në vlerën e tregut dhe likuiditetit të instrumentit themelor. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është si më poshtë:

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare	8	22,049	1,191,228
Depozita me afat	9	6,650,912	2,629,381
Investime në letra me vlerë	10	15,217,124	15,217,124
Aktive të tjera financiare	11	1,687,891	-
Vlera e mbartur		23,577,976	19,037,733

Aktivet financiare të Shoqërisë nuk janë në vones dhe as nuk janë të zhvlerëzuara në datën e raportimi. Cilësia e kredisë është dhënë në shënimet përkatëse.

5.3 Menaxhimi i kapitalit

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga kapitali që i takon zotëruesve të kapitalit të Kompanisë, duke përfshirë kapitalin e emetuar, rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Kompania menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që niveli i kapitalit të mjaftueshëm të mbahet për të qenë në gjendje të vazhdojë si një biznes i vazhdueshëm dhe të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin e palëve të interesuara. Minimumi i kapitalit të kërkuar të përcaktuar me nenin 21 të ligjit nr. 10197 datë 12 dhjetor 2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" është Lek 15,625,000. Më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015, kompania ka përmbushur të gjitha kërkesat për kapital.

6. Vlerësime kritike kontabël dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

7. Paraqitja me vlerën e drejtë

Fondi duhet të klasifikojë, për qëllim paraqitjeje, matjet me vlerë të drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që të reflektojë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes.

7. Paraqitja me vlerën e drejtë (vazhdim)

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e kuotuar në treg ose çmimet e kuotuar nga tregtarët për strumente financiare të tregtuara në tregje aktive. Për të gjithë strumentet e tjera financiare, vlera e drejtë përcaktohet me teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika në vlerë aktuale neto, metoden e fluksit të parasë të skontuar, krahasime me strumente të ngjashme për të cilët çmime të matshme tregu egzistojnë, dhe modele vlerësimi.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e të dhënave gjatë matjes, e cila shpjegohet si më poshtë:

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit të buzara në të dhëna të vrojtueshme, në mënyrë direkte (p.sh. cmimet) ose indirekte (p.sh. të derivuara nga cmimet). Kjo kategori përfshin strumente të vlerësuara duke përdorur çmime tregu të kuotura në tregje aktive për strumente të ngjashme; çmime të kuotuar për strumente identike ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime të kuotuar tregu ose çmime kuotacionesh tregtarësh. Për instrumente financiare që tregtohen rrallë dhe nuk ka transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon grada të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet e çmimeve dhe risqe të tjera që influencojnë instrumentin specifik.

Paraja dhe ekuivalentë të saj

Mjete monetare në arkë dhe bankë dhe depozita me afat përfshin gjendjet monetare në arkë dhe paratë e vendosura në banka rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë barazohet me vlerën që mbartin.

Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë investime në bono thesari dhe obligacione qeveritare. Vlera e drejtë e këtyre investimeve është vlerësuar duke përdorur modelin e vlerës së skontuar të flukseve të parasë duke u bazuar në kurbën korrente të normës së kthimit e përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim. Investimet mbahen me vlerën e drejtë.

Tabela e mëposhtme analizon së bashku me vlerën e drejtë aktivet financiare të Shoqërisë (sipas klasave) matur me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015.

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matjet e vlerës së drejtë të përsëritura.

	Niveli i vlerës së drejtë	Të mbajtura deri në maturim	Kredi dhe të arkëtueshme	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera kontabël e mbartur	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2016						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	Niveli 2	-	22,049	-	22,049	22,049
Depozita me afat	Niveli 2	-	6,650,912	-	6,650,912	6,650,912
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	15,217,124	-	-	15,217,124	15,217,124
31 Dhjetor 2015						
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	Niveli 2	-	1,191,228	-	1,191,228	1,191,228
Depozita me afat	Niveli 2	-	2,629,382	-	2,629,382	2,629,382
Investime në letra me vlerë	Niveli 2	15,217,124	-	-	15,217,124	15,217,124

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

8. Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare në arkë	-	-
Mjete monetare në bankë	22,049	1,191,228
Totali	22,049	1,191,228

Depozitat me afat më pak se 3 muaj janë klasifikuar si mjete monetare dhe ekuivalentë. Gjithë paratë në arkë dhe në bankë përputhen me përkufizimin e mjeteve monetare dhe ekuivalentë.

Më 31 dhjetor 2016, shoqëria nuk ka depozita afatshkurtra të klasifikuara si mjete monetare dhe ekuivalentë (2015: nul). Mjetet monetare të Shoqërisë mbahen nga Tirana Bank, Degë e Bankës Piraeus Greqi e cila është vlerësuar me C nga S&P me një perspektivë të qëndrueshme.

9. Depozita me afat me bankat

Depozitata me afat përfshijnë depozitën e mëposhtme në lekë me Tirana Bank më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozita me afat	6,600,000	2,600,000
Interesi i përlogaritur	50,912	29,381
Totali	6,650,912	2,629,381

Interesi i aplikuar në depozitat me afat varion nga 0.6% - 0.7% (2015: 1.6% - 2.2%)

Depozitat me afat të shoqërisë cilësohen si as të vonuara as të zhvlerësuar. Ato janë vendosur në Tirana Bank, filial i Piraeus Bank i vlerësuar me C nga S&P më 31 dhjetor 2016.

10. Investime në letra me vlerë

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Obligacione qeveritare	15,000,000	15,000,000
Interesi i përlogaritur	217,124	217,124
Total	15,217,124	15,217,124

Maturimi i letrave me vlerë varion nga 5 deri në 7 vjet dhe me norma interesi që variojnë nga 6.45% në 7.78%. Investimet në filiale janë cilësuar si as të vonuara as të zhvlerësuar. Vlerësimi i Shqipërisë sipas Moody's është B1 me një prespektive positive.

11. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fondi i pensionit vullnetar Sigal	1,687,891	-
Aktive të tjera	168,670	2,846,505
Total	1,856,561	2,846,505

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

12. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Automjete	Totali
Kosto				
Më 1 janar 2015	1,266,818	645,637	4,041,000	5,953,455
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	1,266,818	645,637	4,041,000	5,953,455
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	1,266,818	645,637	4,041,000	5,953,455
Zhvlerësimi i akumuluar				
Më 1 janar 2015	669,378	500,600	1,893,753	3,063,731
Amortizimi i vitit	68,229	32,081	207,529	307,839
At 31 dhjetor 2015	737,607	532,681	2,101,282	3,371,570
Amortizimi i vitit	51,952	26,453	193,934	272,339
Më 31 dhjetor 2016	789,559	559,134	2,295,216	3,643,909
Vlera kontabël neto				
Më 31 Dhjetor 2015	529,211	112,956	1,939,718	2,581,885
Më 31 Dhjetor 2016	477,259	86,503	1,745,784	2,309,546

13. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	1,040,825	1,069,662
Sigurime shoqërore dhe shendetësore dhe tatime të tjera	370,431	206,449
Të tjera	110,887	144,495
Totali	1,522,143	1,420,606

14. Kapitali aksionar

Struktura aksionare më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	%	Nr. i aksioneve	Ekivalenti Në Lek	%	Nr. i aksioneve	Ekivalenti Në Lek
Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.	51	24,237	29,084,688	51	24,237	29,084,688
Avni Ponari	49	23,287	27,944,112	49	23,287	27,944,112
Total	100	47,524	57,028,800	100	47,524	57,028,800

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

14. Kapitali aksionar (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përputh numrin e aksioneve në qarkullim në fillim dhe në fund të periudhës:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Numri i aksioneve të autorizuara dhe të paguara plotësisht në fillim të periudhës	45,024	45,024
Numri i aksioneve të lëshuara gjatë periudhës	-	-
Numri i aksioneve të autorizuara dhe të paguara plotësisht në fund të periudhës	47,524	47,524

Minimumi i nevojshëm i kapitalit aksionar i përcaktuar nga artikulli 21 i ligjit nr. 10197 më datë 12 dhjetor 2009 "Mbi fondet vullnetare të pensioneve" është 15,625,000 lekë.

15. Të ardhura nga tarifa e administrimit

	2016	2015
Të ardhura nga tarifa e administrimit	16,804,094	11,417,685
Të ardhura nga komisionet për mbyllje të parakohshme	920,526	537,073
Totali	17,724,620	11,954,758

Tarifa e administrimit llogaritet në baza ditore, si 3% e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.

Komisionet për mbyllje të parakohshme, paguar nga kontribuesit për tërheqjen e parakohshme të kontributeve është llogaritur si përqindje e vlerës së fondit të kontribuesit neto (duke përjashtuar tatimin në burim) në ditën e tërheqjes. Kjo përqindje varjon nga 2 deri në 15%, në varësi të periudhës që kontribuuesi ka investuar në fond.

16. Të ardhura nga interesi

	2016	2015
Të ardhura nga interesat e bonove	1,034,000	542,406
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	21,530	161,363
Totali	1,055,530	703,769

17. Shpenzime personeli

	2016	2015
Shpenzime personeli	10,092,473	8,081,390
Sigurime shoqërore	714,401	869,205
Sigurime shëndetsore	125,237	15,004
Totali	10,932,111	8,965,599

Numri total i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 6 (2015: 6 punonjës).

Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sigal Life UNIQA Group Austria Sh.a.
(të gjitha shumat në Lek, përveçse kur specifikohet ndryshe)

18. Shpenzime Administrative

	Year ended 31 December 2016	Year ended 31 December 2015
Tarifë depozitari	1,120,273	812,604
Qira	420,000	155,000
Shërbime konsulence	397,410	336,390
Programe kompjuterike	366,257	408,066
Tarifë për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare	347,425	155,711
Reklama dhe publicitet	190,713	-
Taksa dhe tarifa	165,133	25,914
Shpenzime përfaqësimi	141,850	16,280
Komisione bankare	110,908	113,837
Telefon	66,203	56,389
Mirëmbajtje	11,480	-
Të tjera	10,075	161,110
Total	3,347,727	2,241,301

Pagesa e depozitarit llogaritet në baza ditore, si 0.2% e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.

Pagesa e AMF llogaritet në baza mujore si 0.05% e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit.

19. Tatim fitimi

Llogaritja vjetore e tatim fitimit është si më poshtë:

	2016	2015
Tatim fitimi aktual	780,029	-
Tatim fitimi i shtyrë	-	-
Tatim fitimi	780,029	-

Një rakordim i shpenzimit të tatim fitimit për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	2016	2015
Fitimi për periudhën	4,227,973	1,143,789
Tatim fitimi sipas normës së përqindjes vendore (15%)	634,196	171,568
Shpenzime jo të zbritëshme	145,833	-
Humbje tatimore të mbartura	-	(171,568)
	780,029	-

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatimit për vitin 2016 është 15% (2015: 15%). Deklaratat tatimore janë plotësuar për çdo vit por fitim-humbjet e deklaruar për qëllime tatimore mbeten si parashikime derisa autoritetet tatimore kontrollojnë ato dhe regjistrimet e taksapaguesit dhe lëshohet një vlerësim final.

Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e palejuara për efekte tatimore paraqesin shpenzime të pambështetura me dokumentacionin përkatës apo shpenzime të konsideruara të panjohura për efekte fiskale.

Shoqëria nuk ka njohur aktive të shtyra tatimore që lidhen me humbje tatimore.

20. Angazhime dhe detyrime të konstatuara

a) Ligjore

Në kursin normal të biznesit Shoqëria merr pretendime ligjore, të cilat nuk i përkasin biznesit kryesor. Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk do të ndodhin humbje materiale në lidhje me ndonjë pretendim ligjor deri me 31 dhjetor 2016.

b) Detyrime qeramarrje

Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë angazhim qiraje operative gjatë viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

21. Transaksionet me palët e lidhura

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie me palët e lidhura të mundshme, fokusi është drejtuar drejt substancës së marrëdhënies dhe jo formës juridike.

Palët e lidhura me të cilat shoqëria ka pasur transaksione janë të shënuara më poshtë:

Pala e lidhur	Marrëdhënia
Sigal UNIQA Group Austria Sh.a	Shoqëria mëmë e grupit në Shqipëri
Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.	Shoqëria mëmë
Avni Ponari	Aksioner
Naim Hasa	Drejtor i përgjithshëm
Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal	Fondi i pensionit

Gjatë vitit Shoqëria ka patur këto transaksione me palët e lidhura:

	2016	2015
Të ardhura nga:		
Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal	16,804,094	11,417,685
	16,804,094	11,417,685
Shpenzime ndaj:		
Stafi manaxherial i rëndësishëm	3,835,860	3,330,960
	3,835,860	3,330,960

22. Ngjarje pas dates së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas periudhës së raportimit që kërkojnë rregullim ose paraqitje në këto pasqyra financiare.